

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6670
E mërkurë, 3 gusht 2022
çmimi 0.40 €

Petritsch: BE-ja duhet të bëjë më shumë për dialogun Kosovë - Serbi



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

VAZHDOJNË REAGIMET PAS NGJARJEVE TË FUNDIT NË VERI TË KOSOVËS | FAQE 4-5

SHEFI I NATO-s KËRKON TË RUHET QETËSIA



Edhe të martën kanë vazhduar reagimet për ngjarjet e fundit në veri. Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka njoftuar se ka biseduar me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, për ngjarjet e fundit në veri të vendit. Stoltenbergu ka thënë se të gjitha palët duhet ta ruajnë qetësinë dhe t'i shmangin veprimet e njëanshme. Ndërsa ambasadori amerikan në Kosovë, Jeff Hovenier,

pasi ka përshëndetur vendimin e qeverisë Kurti për pezullimin e përkohshëm të reciprocitetit me Serbinë, ka thënë se vendimet e shtetit të Kosovës kanë qenë të koordinuara me faktorin ndërkombëtar. Ndërsa presidentja Vjosa Osmani ka thënë se Serbia po ndihmohet nga Rusia për përshkallëzimin e situatës në Kosovë

OPINION

SERBIA NUK E KA PËR QËLLIM VETËM VERIUN E KOSOVËS! F. 6

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



KUJDES, NUK KEMI NEVOJË PËR "TOKË TË DJEGUR" F. 6


Shkruan: Prof. Imer RUSINOVCI



AKTUALE

VRITET LIDERI I AL-KAIDËS, SHBA-ja PËRFUNDON ME SUKSES OPERACIONIN ANTITERRORIZËM F. 2

KAMBERI KËRKON PRANI MË TË MADHE TË SHBA-së NË LUGINË F. 3



EKONOMI

TAHIRI: QEVERIA VENDOS TA SHUAJË AGJENCINË PËR EFIÇENCË TË ENERGJISË F. 8

SPORT



KOSOVA U18 REGJISTRON HUMBJEN E KATËRT F. 10

KLINAKU PUBLIKON LETRAT QË I KËMBYEN ME KURTIN PËR VETERANËT E UÇK-së | FAQE 3



VALBON KRASNIQI JEP DORËHEQJE NGA POZITA E DREJTORIT TË SHSKUK-së | FAQE 6

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Vritet lideri i Al-Kaidës, ShBA-ja përfundon me sukses operacionin antiterrorizëm

KABUL, 2 GUSHT - Udhëheqësi i Al-Kaidës, Ayman Al Zawahiri, është vrarë nga një sulm ajror amerikan. Para se ta jepte urdhrin për të vrarë Ayman al-Zawahirin, presidenti Joe Biden donte të kuptonte saktë se ku fshihej lideri i Al Kaedas. Sulmi me dron i ShBA-së që ka vrarë Zawahirin në ballkonin e tij në qendër të Kabulit ishte produkt i disa muajve të planifikimeve tejet sekrete nga Bideni dhe nga rrethi i ngushtë i këshilltarëve më të lartë të tij. Ndër përgatitjet që janë kryer ishte edhe modeli për vrasjen e tij në shkallët e vogla të shtëpisë së sigurt të Zawahirit, i cili është hartuar nga zyrtarë të inteligjencës dhe është paraqitur brenda Shtëpisë së

Bardhë para Bidenit për ta shqyrtuar derisa debatonte për opsionet, shkruan "CNN". Për Bidenin, mundësia për ta hequr qafe terroristin më të kërkuar të botës, njërin nga organizatorët e sulmeve të 11 shtatorit 2001, bartte plot rreziqe për vrasjen aksidentale të civilëve në kryeqytetin afgan – ashtu siç ndodhi me një sulm tjetër të ShBA-së me dron 11 muaj më parë gjatë tërheqjes kaotike të ushtrisë amerikane nga vendi. Detajet e sulmit dhe planifikimit të tij janë zbuluar nga një zyrtar i lartë i administratës, ndërsa Bideni po përgatitej të njoftonte për të. Gjatë gjithë përpjekjeve disamujore për ta planifikuar

sulmin e kësaj fundjave, Bideni në mënyrë të vazhdueshme i ka porositur zyrtarët e tij të sigurojnë që civilët, përfshirë anëtarët e familjes së Zawahirit, që të mos vriteshin. Asnjë prej tyre nuk ishte aty, sipas Shtëpisë së Bardhë. Bideni, i cili ishte i izoluar për shkak të infektimit me Covid-19 gjatë diskutimeve përfundimtare dhe autorizimit të sulmit, ka dalë për ta shpallur këtë sukses në ballkonin e Shtëpisë së Bardhë të hënën. Ishte një moment fitoreje për një president, i cili është rrethuar nga problemet e brendshme politike që shtrihen deri në tërheqjen "vdekjeprurëse" nga Afganistani një vit më parë. Bideni është informuar për herë



të parë në prill nga një raport i inteligjencës amerikane që tregonte për Zawahirin se jetonte në një shtëpi të sigurt në Kabul. Zyrtarët amerikanë kishin qenë në dijeni të një rrjeti që

mbështeste liderin terrorist në kryeqytetin afgan prej muajsh dhe kishin arritur ta identifikonin gruan, vajzën dhe fëmijët e saj përmes mënyrave të shumta të inteligjencës.

ShBA-ja vendos katër anije luftarake në lindje të Tajvanit

TAIPEI, 2 GUSHT - Derisa kryetarja e Dhomës së Përfaqësuesve të ShBA-së, Nancy Pelosi, është nisur për në kryeqytetin e Tajvanit të martën mes paralajmërimeve të intensifikuara nga Kina, katër anije luftarake amerikane, duke përfshirë një aeroplanmbajtëse, u pozicionuan në ujëra në lindje të ishullit. Transportuesi i "BRSS Ronald Reagan", që kishte kaluar transit në detin e Kinës Jugore, aktualisht është në detin e Filipineve, në lindje të Tajvanit dhe Filipineve dhe në jug të Japonisë, konfirmoi një zyrtar i marinës amerikane për "Reuters"-in të martën. "Ronald Reagan (CVN 76)" është aeroplanmbajtësja e nëntë e klasës Nimitz me energji bërthamore dhe është emëruar kështu për nder të presidentit të 40 të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA-së). "Derisa ato janë në gjendje t'i përgjigjen çdo eventualiteti, këto janë zhvendosje normale rutinore", ka thënë një zyrtar amerikan në kushte anonimiteti, raporton "Rel". Zyrtari i marinës amerikane ka thënë se anija sulmuese "BRSS



Tripoli" ishte gjithashtu në zonë si pjesë e një dislokimi në rajon që nisi në fillim të majit nga porti i saj i origjinës, San Diego. Konfirmimi i dislokimeve është bërë pasi janë shfaqur shenja të aktivitetit ushtarak në të dyja anët e ngushticës së Tajvanit para vizitës së Pelosit. Pelosi, kritike për një kohë të gjatë e Kinës, pritet të mbërrijë në Taipei më vonë të martën, thanë burimet, pasi Shtetet e Bashkuara deklaruan se nuk do të frikësoheshin nga "kërcënimi i forcës ushtarake" kineze gjatë vizitës. Përveç aeroplanëve kinezë që

fluturonin afër vijës ndarëse të martën në mëngjes, disa anije luftarake kineze kishin mbetur pranë kësaj vije që nga e hëna, i ka thënë "Reuters"-it një burim i informuar për këtë çështje. Burimi ka thënë se si anijet luftarake dhe avionët kinezë "ngushtuan" vijën ndarëse të martën në mëngjes, një lëvizje e pazakontë që burimi e përshkroi si "shumë provokuese". Burimi ka thënë se avioni kinez ka kryer në mënyrë të përsëritur lëvizje taktike për ta "prekur" shkurtimisht vijën ndarëse dhe duke u rrotulluar përsëri në anën tjetër të ngushticës të martën në

mëngjes, ndërsa avionët tajvanë ishin në gjendje gatishmërie aty pranë. Ministria e Mbrojtjes dhe ajo e Punëve të Jashtme e Kinës nuk u janë përgjigjur kërkesave për të komentuar mbi këto zhvillime. Kina ka thënë të martën se Shtetet e Bashkuara do ta "paguajnë çmimin" nëse Pelosi viziton Tajvanin gjatë udhëtimit të saj në Azi. "Pala amerikane do të mbajë përgjegjësi dhe do ta paguajë çmimin për minimin e interesave të sigurisë sovraane të Kinës", ka thënë zëdhënësja e ministrisë së Jashtme, Hua Chunying, në një konferencë të rregullt për medie në Pekin. Kina e konsideron Tajvanin territor të vet dhe ka treguar përmes paralajmërimeve të përsëritura se do ta konsideronte vizitën e Pelosit si një provokim të madh. Avionët e asnjërës palë normalisht nuk e kalojnë vijën ndarëse në mes të Tajvanit dhe Kinës. Ministria e Mbrojtjes e Tajvanit ka thënë të martën se zotëron plotësisht aktivitetet ushtarake pranë Tajvanit dhe do t'i dërgojë forcat në mënyrë proporcionale me reagimin ndaj "kërcënimeve të

armikut" derisa tensionet me Kinën rriten. Ministria kishte "përforcuar" nivelin e saj të gatishmërisë luftarake nga e marta në mëngjes deri në mesditën e së enjtes, njoftoi Agjencia Qendrore e Lajmeve e Tajvanit, duke cituar burime të paidentifikuara. Në qytetin juglindor kinez Xiamen, i cili shtrihet përballë Tajvanit dhe është një bazë madhe ushtarake, banorët kanë raportuar se kishin parë automjete të blinduara në lëvizje dhe kanë publikuar fotografi në internet. Në mediet sociale kineze mbizotëronte frika, si nga konflikti i mundshëm, ashtu edhe nga entuziazmi patriotik mbi perspektivën e bashkimit me Tajvanin. Që nga java e kaluar Ushtria Çlirimtare Popullore ka kryer stërvitje të ndryshme, duke përfshirë ato me zjarr të drejtpërdrejtë, në detin e Kinës Jugore, Detin e Verdhë dhe Bohan. Disa analistë ushtarakë rajonalë kanë thënë se shtimi i dislokimeve në kohë tensionesh rrit rrezikun për aksidente, edhe nëse asnjë palë nuk dëshiron një konflikt aktual.

Guterresi paralajmëron rrezikun e një lufte bërthamore: Është vetëm një hap larg

NYU-JORK, 2 GUSHT - Sekretari i përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara të Amerikës (OKB), Antonio Guterres, ka paralajmëruar se bota është vetëm një hap larg nga një luftë shkatërruese bërthamore dhe se bota ndodhet në një rrezik që nuk është parë që nga Lufta e Ftohtë. "Mes tensioneve globale në rritje, njerëzimi

është vetëm një keqkuptim, një llogaritje e gabuar larg asgjësimit bërthamor", ka thënë ai. Komitetet e Guterresit janë bërë gjatë hapjes së konferencës për vendet e anëtarësuar në Traktatin e mospërhapjes bërthamore, raporton BBC-ja. Marrëveshja e vitit 1968 është prezantuar pas krizës së raketave kubane.

Traktati ishte krijuar për ta ndaluar përhapjen e armëve bërthamore në më shumë vende dhe për ta ndjekur qëllimin përfundimtar të çarmatimit të plotë bërthamor. Pothuajse çdo komb në Tokë ka nënshkruar marrëveshjen, duke përfshirë pesë fuqitë më të mëdha bërthamore. Por në mesin e disa shteteve që nuk nënshkruan kurrë

marrëveshjen janë katër vende të njohura ose të dyshuara për armë bërthamore: India, Izraeli, Koreja e Veriut dhe Pakistani. Sekretari Guterres ka thënë se "fati" që bota ka gëzuar deri më tani në shmangien e një katastrofe bërthamore mund të mos zgjasë shumë. Në këtë mënyrë sekretari i përgjithshëm i OKB-së i ka



kërkuar botës ta rinovojë traktatin për eliminimin e të gjitha armëve të tilla.

Klinaku publikon letrat që i këmbyen me Kurtin për veteranët e UÇK-së

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 2 GUSHT - Ushtruesi i detyrës i kryetarit të Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Faton Klinaku, ka publikuar letrat e këmbjera me kryeministrin Albin Kurti për çështjen e veteranëve, të cilët kanë protestuar dy herë për përfshirjen në Projektligjin për Pagën Minimale.

Në letrën e publikuar nga Klinaku, kryeministri Kurti ka kërkuar hartimin e një ligji të ri i cili do të niste një proces vlerësimi dhe verifikimi për të gjithë pjesëmarrësit e luftës çlirimtare.

Derisa të përfundojë procesi i ri, si mbështetje shtesë Kurti ka thënë mund të ofrojnë përkrahje për punësimin e veteranëve përmes masave aktive të tregut të punës. Por, në përgjigjen e OVLUÇK-së është konsideruar ndërhyrje në procesin gjyqësor propozimi për hartimin e një ligji të ri i cili do të niste një proces vlerësimi dhe verifikimi për të gjithë pjesëmarrësit e luftës

çlirimtare. “Organizatata e dala nga lufta e UÇK-së nuk kanë qenë dhe nuk janë kompetente për vlerësim e verifikim, por janë të hapura për bashkëpunim... Neve na intereson që veteranët e luftës së UÇK-së të trajtohen dinjitetshëm dhe do të ishte mirë që të hiqet neni që ua ndalon punësimin atyre”, është thënë në letrën e OVLUÇK-së dërguar Kurtit.

Ndërsa propozimet e kryeministrit Kurti kanë qenë këto: “Të fillojmë menjëherë bashkërisht hartimin e një ligji të ri, i cili nis një proces vlerësimi e verifikimi për të gjithë pjesëmarrësit e luftës çlirimtare. Me këtë ligj do të sigurojmë nxjerrjen e një liste të saktë të të gjithë atyre që kanë kontribuar në luftën çlirimtare. Hartimi i ligjit dhe procesi i verifikimit të kryhet në një kohë sa më të shpejtë. Ndërkohë derisa të përfundojë procesi i ri, si mbështetje shtesë mund të ofrojmë përkrahje për punësimin e veteranëve përmes masave aktive të tregut të punës, duke subvencionuar një pjesë të pagës për një periudhë të caktuar”.



Hoxhaj: Deklaratat në Tiranë dhe Vietnam ia ‘varrosën’ shansin Kosovës për t’u njohur nga pesë vendet e BE-së

PRISHTINË, 2 GUSHT (ER) - Nën kryetari i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës, Enver Hoxhaj, ka thënë se Kosova deri të hënën ka pasur mundësi ta marrë njohjen e pesë shteteve të Bashkimit Evropian që deri më tani nuk e njohin shtetin tonë “për shkak të rënies strategjike të Rusisë dhe izolimit të Serbisë”.

Ai ka thënë se qëndrimi i kryeministrit të Spanjës në Tiranë dhe ai i ministrit të Jashtëm grek në Vietnam kanë qenë kundër njohjes së pavarësisë dhe, sipas tij, këto e “varrosën përfundimisht një momentum dhe shans historike për një kohë të gjatë”. “Argumenti



i rrejshëm i tyre kur GjND-ja e ka vulosur ligjshmërinë e pavarësisë sonë është vetëm hipokrizi dhe është vetëm në

shërbim të Rusisë dhe assesi të BE-së! Koha para nesh është një kohë e vetmisë dhe papërgjegjësisë së qeverisë Kurti”,

ka shkruar Hoxhaj në “Facebook”. Kryeministri i Spanjës, Pedro Sanchez, të hënën në Tiranë ka folur edhe për qëndrimin e Spanjës ndaj njohjes së Kosovës, duke deklaruar se është shkelur e drejta ndërkombëtare. “Miqhtë e mirë si Shqipëria dhe Spanja mund të kenë mosmarrëveshjet e tyre. Ne mendojmë se është një shpallje e njëanshme e pavarësisë dhe mendojmë se është shkelur e drejta ndërkombëtare, ndaj nuk mund të jemi pro këtij pranimi. Këtë e themi me gjithë respektin që kemi për popullin shqiptar. Është një mendim që e ndajmë me Shqipërinë, por kjo nuk do të thotë se në kuadër të integritimeve evropiane nuk e promovojmë dialogun ndërmjet Serbisë dhe Prishtinës. Ky është pozicioni që kemi. Edhe miqtë e mirë mund të kenë dallime apo kontradikta mes njëri-tjetrit”, ka thënë kryeministri spanjoll.

Lidhur me Kosovën është pyetur edhe ministri i Jashtëm grek, Nikos Dendias, i cili të hënën ka qëndruar në një vizitë në Vietnam. Ai ka thënë se stabiliteti dhe siguria në rajon është e rëndësishme për Greqinë, derisa kërkoi që të respektohet e drejta ndërkombëtare. Dendias ka thënë se është mjedisi ai që do t’i lejojë Kosovës dhe Serbisë të diskutojnë dhe t’i zgjidhin mosmarrëveshjet.

Kamberi kërkon prani më të madhe të ShBA-së në Luginë

BEOGRAD, 2 GUSHT (ER) - Deputeti shqiptar në Kuvendin e Serbisë, Shaip Kamberi, është takuar më martën me ambasadorin amerikan në Serbi, Christopher R. Hill, me të cilin ka diskutuar për gjendjen e shqiptarëve atje.

Kamberi, i cili është pritur në Ambasadën Amerikane në Beograd, ka thënë se i ka treguar ambasadorit Hill për kërkesat që koalicioni i tij ia ka dërguar

presidentit serb Aleksandër Vuçiq. “Në Ambasadën e ShBA-së në Beograd bashkëbisedova sot me ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Sh. T. Christopher R. Hill. Me ambasadorin Hill bashkëbiseduam për kërkesat të cilat në emër të koalicionit të shqiptarëve të Luginës ia kemi dhënë presidentit Vuçiq për nevojën e realizimit të planit shtatëpikësh dhe për situatën

në Luginë në përgjithësi”, ka shkruar Kamberi në “Facebook”.

Ai ka theksuar se prania më e madhe e ShBA-së në Luginë dhe përkrahja e kërkesave të tyre legjitime ishin temë e bashkëbisedimit me Hillin. “Prania më e madhe e ShBA-së në Luginë dhe përkrahja e kërkesave tona legjitime ishin temat e bashkëbisedimit tonë”, ka shkruar Kamberi.





VAZHDOJNË REAGIMET PAS NGJARJEVE TË FUNDIT NË VERI TË KOSOVËS

Shefi i NATO-s kërkon të ruhet qetësia

Edhe të martën kanë vazhduar reagimet për ngjarjet e fundit në veri. Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka njoftuar se ka biseduar me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, për ngjarjet e fundit në veri të vendit. Stoltenbergu ka thënë se të gjitha palët duhet ta ruajnë qetësinë dhe t'i shmangin veprimet e njëanshme. Ndërsa ambasadori amerikan në Kosovë, Jeff Hovenier, pasi ka përshëndetur vendimin e qeverisë Kurti për pezullimin e përkohshëm të reciprocitetit me Serbinë, ka thënë se vendimet e shtetit të Kosovës kanë qenë të koordinuara me faktorin ndërkombëtar. Ndërsa presidentja Vjosa Osmani ka thënë se Serbia po ndihmohet nga Rusia për përshkallëzimin e situatës në Kosovë

**EPOKA
ERE**

Lirim GECI

PRISHTINË, 2 GUSHT - Pas ngjarjeve të fundit në veri, gjithçka i është kthyer normalitetit në pikën kufitare që lidh Kosovën me Serbinë, në Jarinjë. Ajo është e hapur për qarkullim, ndërsa nuk ka kolona dhe as nevojë për pritje të gjata nga të dyja anët e kufirit. Por, reagimet për ngjarjet e javës së kaluar në veri të Kosovës kanë vazhduar edhe të martën. Fillimisht ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Jeff Hovenier, e ka mirëpritur vendimin e liderëve të Kosovës për ta pezulluar përkohësisht zbatimin e reciprocitetit ndaj Serbisë, i cili kishte çuar në tensionimin e situatës në veri, ku serbët kishin vendosur

barrikadat në rrugët kryesore të katër komunave veriore. Hovenieri në llogarinë e vet në "Twitter" ka shkruar se dy masat e vendosura nga qeveria, ajo për targa dhe dokumentet e udhëtimit, janë plotësisht në përputhje me marrëveshjet e Brukselit dhe se ishin të koordinuara me komunitetin ndërkombëtar. "ShBA-ja mirëpret vendimin e liderëve të Kosovës për ta pezulluar përkohësisht zbatimin e masave të reciprocitetit për targa dhe dokumentet hyrëse/dalëse. Të dyja masat janë plotësisht në përputhje me marrëveshjet e Brukselit dhe ishin të koordinuara me komunitetin ndërkombëtar", ka shkruar ambasadori Hovenier. Në kuadër të këtyre ngjarjeve,

sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka bërë me dije se të martën ka biseduar me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, lidhur me ngjarjet e fundit në veri të vendit. Përmes llogarisë së vet në "Twitter", Stoltenbergu ka thënë se të gjitha palët duhet ta ruajnë qetësinë dhe t'i shmangin veprimet e njëanshme. "Bisedova me Albin Kurtin për tensionet e fundit në Kosovë dhe për rëndësinë e vazhdueshme të misionit të KFOR-it. Të gjitha palët duhet të ruajnë qetësinë, t'i shmangin veprimet e njëanshme dhe ta mbështesin dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja. Mbetem në kontakt të ngushtë me Prishtinën dhe Beogradin", ka shkruar Stoltenbergu. Ndërsa presidentja e Kosovës, në

një intervistë për BBC-në, ka thënë se Serbia po ndihmohet nga Rusia për përshkallëzimin e situatës në Kosovë. "Tensionet për përshkallëzohen. Megjithatë, ka pasur përgatitje nga Serbia, e ndihmuar dhe e nxitur nga Rusia për një kohë të gjatë, për të tentuar përshkallëzimin e Ballkanit. Perëndimor në përgjithësi dhe në Kosovë në veçanti. Në dekadën e fundit që Vuçiqi ka drejtuar Serbinë, por veçanërisht në muajt e fundit ku ata vazhduan t'i mbështesin strukturat ilegale në veri të Kosovës të cilat përbëhen nga bandat kriminale. Nëpërmjet tyre dhe duke i manipuluar, ata janë duke e mbajtur pakicën serbe që jeton në Kosovë peng të këtyre politikave të gabuara", ka thënë Osmani. Shefja e shtetit ka theksuar se edhe nëpërmjet reciprocitetit të aplikuar nga Kosova janë duke u respektuar marrëveshjet e arritura ndërmjet dy palëve në Bruksel. Më tutje, ajo ka thënë se Kosova është pala konstruktive në dialog dhe se nuk është larguar asnjëherë nga dialogu. E pyetur nëse Kosova rrezikon të kthehet në një Ukrainë të dytë, presidentja Osmani ka thënë se po sigurohen që të mos ndodhë një skenar i këtillë. Osmani ka thënë se Kosova kurrë

nuk ka kontribuar dhe nuk do të kontribuojë në përshkallëzim të situatës apo dhunë. "Ne duhet të kuptojmë se jetojmë afër një fqinji që kontrollohet plotësisht nga Rusia. Ata po e luftojnë mënyrën tonë demokratike të jetës. Kjo është një luftë kundër vlerave me të cilat jetojmë çdo ditë dhe të cilat qëndrojnë në themelet e shtetit tonë të pavarur. Nuk janë akuzat tona ato që përshkallëzojnë situatën, janë veprimet e tyre që përshkallëzojnë situatën dhe po krijojnë tensione. Pra, praktikisht, nëse e themi të vërtetën për synimet e Rusisë dhe Serbisë, kjo nuk do të ndikojë negativisht. Kjo ka një efekt pozitiv, sepse nuk besoj se e ndihmon situatën akomodimi i autokratëve dhe i regjimeve gjenocidale, siç është ai në Rusi, apo regjimeve autokratike që synojnë të bëjnë të njëjtën gjë në Serbi", ka thënë Osmani.

**"Ndërkombëtarët
asnjëherë nuk do ta
pranojnë thyerjen
e 'status quo'-s"**

Ndërsa kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, edhe të martën, pasi ka përshëndetur vendimin e qeverisë Kurti për shtyrje për 30

Petritsch: BE-ja duhet të bëjë më shumë për dialogun Kosovë - Serbi

PRISHTINË, 2 GUSHT - Diplomati Wolfgang Petritsch ka thënë se zyrtarët në Kosovë dhe Serbi duhet të çarmatosen verbalisht ashtu që të shtensionohet situata e krijuar në veri të Kosovës. Në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", Petritsch, ish-i dërguari i Bashkimit Evropian për Kosovën dhe ish-përfaqësues i Lartë për Bosnjë e Hercegovinën, ka thënë se Qeveria e Kosovës ka marrë vendim të mençur për shtyrjen e zbatimit të vendimeve për targarat dhe dokumentet serbe.

Sipas tij, BE-ja duhet të bëjë më shumë për dialogun që e ndërmjetëson në mes të Kosovës dhe Serbisë, dhe ky shembull tregon sesi zvarritja e procesit nuk funksionon. "Tash e sa muaj nuk është bërë mjaftueshëm në procesin e dialogut. Dhe, ja ku është rezultati. Në muajt e kaluar nuk kanë ndodhur shumë gjëra, në fakt asgjë nuk ka ndodhur. Këto lloje konfliktesh mes Kosovës dhe Serbisë duhet të ndalen. Bashkimi Evropian ka shumë përgjegjësi për këtë gjë. (Miroslav) Lajçak

besoj se është i zënë natë e ditë për zgjidhje të situatës, mirëpo ai duhet të arrijë përparim edhe në aspektin e zbatimit dhe zgjidhjes së konfliktit. Bashkimi Evropian është pranuar nga të dyja palët si ndërmjetësues. Prandaj, blloku evropian është në rol udhëheqës, duket të jetë aktiv dhe prezent në Beograd dhe Prishtinë, në mënyrë që të shohim rezultate. BE-ja duhet ta rrisë angazhimin. Ky është një nga shembujt më të rrezikshëm sesi zvarritja nuk funksionon. Dialogu nuk duhet të

ndalet. Nëse ndalet, rrëshqasim në konflikt. Ecja përpara është strategjia që mund të rezultojë e suksesshme", ka deklaruar Petritsch. Duke folur për situatën e fundit në veri, ai ka theksuar se është shumë e rëndësishme që të ulen tensionet. "Kjo është çështja më e rëndësishme tani. Po flas në pamje më të gjerë që përfshin Evropën Lindore dhe atë Juglindore, sepse për shkak të luftës në Ukrainë situata është bërë shumë më emocionale dhe

më e paqëndrueshme. Natyrisht që agresioni i Rusisë kundër Ukrainës ka ndikim edhe në Ballkan, pasi e dimë se aktorë të mëdhenj, Rusia, Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian, janë të përfshirë në çështjen e Ukrainës. Ata janë edhe aktorë të jashtëm në Ballkan. Pra, ekziston një lloj ndërlidhjeje që e bën edhe më të rëndësishme uljen e tensioneve dhe uljen në tavolinën negociuese, nën ndërmjetësim të Bashkimit Evropian", ka thënë Petritsch.



ditë të vendimit për vendosje të reciprocitetit me Serbinë, e ka vazhduar mbështetjen për shtetin e Kosovës. Ai në llogarinë e vet zyrtare në "Twitter" ka shpërndarë postimin e kryeministrit Albin Kurti, në të cilin ndodhet komunikata e plotë e qeverisë me mbishkrimin: "Në bashkëpunim me partnerët tanë ndërkombëtarë, ne jemi zotuar për ta shtyrë zbatimin e vendimit për targarat e veturave dhe dokumentet për hyrje-dalje në pikat kufitare me Serbinë për 30 ditë me kushtin që të gjitha barrikatat të jenë larguar dhe që lëvizja e lirë të jetë rivendosur".

Në raport me këto ngjarje ka reaguar edhe njëri nga ish-kryesuesit e ekipit negociator të Kosovës, Shpend Ahmeti. Ai ka thënë se ndërkombëtarët asnjëherë nuk do t'i aprovojnë vendimet e institucioneve të Kosovës për thyerjen e "status quos". "Pa komentuar efektin e vendimit të qeverisë për dokumentet dhe tabelat, është interesante që pyetja e vetme e opozitës është se a ka pasur koordinim me faktorin ndërkombëtar. Çka është koordinimi? Kërkim leje? Aprovim? Informim? Një gjë është e qartë, asnjëherë nuk do

të ketë aprovim nga 'faktorit' ndërkombëtar për thyerje të 'status quo'-s. Prandaj nuk mund të ketë koordinim. Se a i ka vlerësuar qeveria mirë reagimet, pasojat dhe koston, është pyetje krejt tjetër. Vlerësimi i tyre dhe marrja parasysh e kostove është punë e qeverisë. Kjo mund të jetë debat. Opsioni tjetër është vetëm 'status quo', që gjithmonë është opSION pa kosto të madhe politike për zyrtarët", ka shkruar Ahmeti në "Facebook". Kurse drejtori i së ashtuquajturës Zyrrë për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petkoviç, ka thënë se lidhur me vendimin për

reciprocitet të Kosovës me dokumente do të kërkojnë zgjidhje kompromisi në Bruksel. Ai për "TV Pink" është shprehur se Beogradi nuk do të lejojë që të anulohen dokumentet serbe. "Nuk ka më lëshim të dokumenteve hyrëse-dalëse që Prishtina ka dashur t'ua imponojë qytetarëve të Serbisë që hyjnë në 'Kosovë e Metohi'. Në këtë mënyrë ne jemi kthyer në një pozicion ku të gjitha këto çështje mund t'i diskutojmë në Bruksel. Do të jetë një luftë e fortë dhe intensive për ta normalizuar situatën me zgjidhje kompromisi. Prandaj

është e nevojshme të jemi në Bruksel. Nuk kemi ikur nga dialogu", është shprehur Petkoviç. Ai ka thënë se Aleksandër Vuçiqi e ka refuzuar takimin me Albin Kurtin në Bruksel më 19 korrik me arsyetimin se kanë qenë të përgatitur për atë që do të ndodhte më 1 gusht. Qeveria e Kosovës kishte marrë vendim për vendosjen e reciprocitetit për dokumente me Serbinë nga 1 gushti, por pas vendosjes së barrikadave në veri dhe kërkesës amerikane, ky vendim është pezulluar deri më 1 shtator.

Valbon Krasniqi jep dorëheqje nga pozita e drejtorit të ShSKUK-së

PRISHTINË, 2 GUSHT (ER) - Bordi drejtues i Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka njoftuar se ka miratuar dorëheqjen e Valbon Krasniqit nga pozita e drejtorit të ShSKUK-së.

Në vend të Krasniqit, ushtruese e detyrës është emëruar Pranvera Zejnullahu - Raçi. "Ju njoftojmë se

bordi drejtues i ShSKUK-së, në mbledhjen e mbajtur me datë 02.08.2022, ka miratuar dorëheqjen e drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK), dr. Valbon Krasniqi. Bordi Drejtues i ShSKUK-së me këtë rast, duke vlerësuar kontributin e

deritanishëm të dr. Krasniqit, e falënderon për bashkëpunimin e treguar. Po ashtu, ju njoftojmë se, bazuar në kompetencat e veta, bordi drejtues i ShSKUK-së ka emëruar ushtruesen e detyrës së drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit Spitalor Universitar të Kosovës, dr. Pranvera Zejnullahu-Raçi", ka njoftuar ShSKUK-ja.



Policia fillon punën me pajisje që identifikojnë kundërvajtjet në trafik

PRISHTINË, 2 GUSHT (ER) - Policia e Kosovës ka paraqitur "Patrullën inteligjente", pajisje këto të cilat do ta identifikojnë shpejtësinë, mjetet e paregjistruara, personat të cilët janë në kërkim dhe kundërvajtje të tjera në trafikun rrugor.

Përmes këtyre pajisjeve do të mundësohet shqiptimi i gjobave në mënyrë digjitale. Policia do ta fillojë përdorimin e këtyre pajisjeve, por ndaljet nga policia në trafik do të vazhdojnë deri kur teknologjia të lidhet në tërësi me databazën.

Drejtori i Policisë së Kosovës, Samedin Mehmeti, duke e prezantuar "Patrullën inteligjente", ka pranuar që situata në trafikun rrugor nuk është e mirë, ndërsa ka theksuar rëndësinë e digjitalizimit të komunikacionit. "Qytetari i Kosovës ta kuptojë se në ditët e ardhshme në komunikacion do

të jenë automjete dhe mjete teknike të cilat totalisht e ndryshojnë qasjen e policisë ndaj kundërvajtësve. Deri sot në këtë kohë zakonisht kundërvajtjet janë identifikuar përmes ndalimit. Policia e ka ndaluar kundërvajtësin duke identifikuar personin dhe ka shqiptuar masën e dënimit. Në këtë periudhë identifikimi i kundërvajtjeve do të bëhet nga vetë pajisjet teknike, sensorët, radarët dhe kamerat të cilat janë të instaluar në automjetet që bëjnë identifikimin e kundërvajtjeve. Do të vijë koha kur databazat tona do të konektohen me automjetet dhe nuk do të ketë nevojë për ta ndaluar mjetin, por gjoba do të shqiptohet në mënyrë elektronike", ka thënë Mehmeti në një konferencë për medie. Ai ka treguar se këto pajisje identifikojnë tejkalimin e shpejtësisë, automjetet e



paregjistruara, njerëzit apo targat që janë në kërkim, pikët negative si dhe mundësojnë shqiptimin e gjobave në mënyrë elektronike, të cilat pastaj me postë u dërgohen kundërvajtësve. "Një element tjetër që identifikon kjo teknologji është mundësia e identifikimit digjital, përkatësisht shqiptimit të gjobave digjitale. Teknologjia mundëson të identifikohet kundërvajtja dhe të bartet në databazë, dhe tek atëherë me automatizëm do të shqiptohet gjoba. Gjithashtu, pajisja

mundëson identifikimin e figurave ose njerëzve të cilët mund të jenë në kërkim", është shprehur Mehmeti, duke shtuar se veturat që përmbajnë këto pajisje do të jenë në tërë territorin e Republikës së Kosovës. "Veturat do të jenë të pranishme në të gjitha pjesët e territorit të Republikës së Kosovës, në veri, lindje, jug dhe në çdo qytet, pra të mos them në çdo fshat. Databazat tona konektohen dhe natyrisht që kushdo që hyn dhe del nga Republika e Kosovës regjistrohet në kufi", ka thënë Mehmeti.

ShSKUK-ja pa punëtorë të rinj që nga viti 2019

PRISHTINË, 2 GUSHT (ER) - Pak orë para dorëheqjes, drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK), Valbon Krasniqi, ka thënë se ky institucion nuk ka pasur asnjë punëtor të ri që nga viti 2019.

Këtë deklaratë Krasniqi e ka bërë të martën gjatë mbledhjes së Komisionit për Financa Publike, ku ka qenë i ftuar edhe ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, por ka munguar. "Numri i të punësuarve në ShSKUK nuk është rritur dhe gjendet

përballë një krize serioze për shkak të mungesës së stafit. Kemi funksionalizuar stafin e pediatrikës, tash edhe mjekësinë sportive", ka thënë Krasniqi.

Duke folur për raportin e auditimit për pasqyrat financiare të ShSKUK-së për punën njëvjeçare, Krasniqi ka thënë se aktivitetet nuk janë të lidhura me të. "Të gjitha këto aktivitete nuk janë të lidhura me menaxhmentin aktual. Ne kemi përgatitur planin e veprimit dhe do të formohet një komision i veçantë. Sa i përket nënvlerësimit dhe

mbivlerësimit të pasurisë mbi 1 000 euro janë 5 aktivitete, dy prej tyre lidhen me pagesën e aparatit të klinikës. Për t'u siguruar për ardhjen e barnave ka në funksion stokun farmaceutik. Për çdo pagesë vjen pranimi i mallit dhe regjistrohet në sistem elektronik. Këtë sistem e kemi shtrirë deri te barnatoret e reparteve. Një ilaç që vjen në barnatore qendrore regjistrohet në sistem elektronik. Mbi 20 mijë barna kemi regjistruar në sistem elektronik", ka thënë Krasniqi.



Jasharaj, ministres Nagavci: Sa shumë të kanë ndryshuar funksioni dhe kolltuku

EPOKA
ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 2 GUSHT - Kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), Rrahman Jasharaj, ka reaguar ndaj deklaratës së ministres së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHIT), Arbërie Nagavci, e cila paralajmërimin e kësaj sindikate për grevë më 1 shtator e ka quajtur kërcënim dhe veprim i papranueshëm.

Jasharaj ka thënë se i vjen keq se sa shumë e ka ndryshuar Nagavcin funksioni dhe kolltuku. "SBASHK-u do të ndihet e lumtur sikur ministrja Nagavci me deklarinimin e saj publik të sillte lajmin se pas angazhimeve të saj, qeveria, më në fund, ka ndryshuar qasjen ndaj dialogut me sindikatat dhe se do të nisë takimet në përpjekje për të gjetur bashkërisht zgjidhje për kërkesat legjitime të SBASHK-ut dhe sindikatave të tjera për të mos pasur nevojë për veprime sindikale dhe për grevën e përgjithshme. Mirëpo kjo nuk ndodhi e në vend të kësaj ministrja paralajmërimin për grevë e quan kërcënim dhe tregon se as ajo e as qeveria nuk e kanë në mendje ta ndryshojnë qasjen me sindikatat e as nuk do të qajnë kokën për kërkesat e tyre, prandaj ky paralajmërimi ynë, që nuk është kërcënim, po alarm, do të kthehet në realitet dhe greva e përgjithshme do të ndodhë, fatkeqsisht, dhe fajtore e vetme për këtë është qeveria Kurti. Ajo që na bën të ndihemi edhe më keq është se, fatkeqsisht, funksioni e kolltuku e kanë ndryshuar shumë znj. Nagavci", ka thënë Jasharaj në reagimin publik.

Ai ka bërë me dije se ministrja Nagavci sa ishte në opozitë i përkrahte veprimet e SBASHK-ut. "Ajo dikur si deputete dhe anëtare e Komisionit Parlamentar për Arsim ishte shumë e zëshme dhe në janarin e vitit 2019 kishte deklaruar publikisht kur SBASHK-u ishte në grevë dhe pikërisht për shkak të pakënaqësive lidhur me Ligjin e Pagave, se 'greva që nuk e deshën as vetë mësimmshënësit, erdhi si rezultat i keqqeverisjes', duke të shtuar, veç të tjerash, edhe se '...sikur qeveria të mos i injoronte shqetësimet e SBASHK-ut, sot nuk do t'i krijonte pakënaqësitë që i ka krijuar dhe nxënësit nuk do të mbetnin në shtëpitë e tyre. Shkaktari i vërtetë i grevës është Qeveria e Kosovës", është shprehur Jasharaj.

Më tutje, Jasharaj ia ka bërë me dije Nagavci që kërkesat e SBASHK-ut asnjëherë nuk kanë ndryshuar. "Ministre, atëherë dhe tani SBASHK-u ishte dhe mbetet po kjo e njëjta dhe kërkesa kryesore edhe tani lidhet me Ligjin e Pagave, por tani ju mundoheni ta arsyetoni qeverinë pa as edhe një argument dhe se është fajtorja e vetme dhe e kritikoni pa as edhe një fakt SBASHK-un. Sa shumë ju kanë ndryshuar funksioni dhe kolltuku juve, znj. Nagavci. Ministre, opinionit duhet thënë të vërtetën dhe nëse bazohemi në fakte, atëherë SBASHK-u dhe sindikatat e tjera më shumë se në të kaluarën tani kanë arsye të shkojnë në veprime sindikale dhe në grevë të përgjithshme sepse dërguam dhjetëra herë shkresa për takime me institucionet me qëllim që të bisedojmë për kërkesat e anëtarësisë dhe të



mundoheshim bashkërisht të gjejmë zgjidhje të pranueshme, por qeveria heshti ndaj këtyre angazhimeve tona dhe i iku dialogut dhe takimeve. Për ta nxitur qeverinë për dialog e marrëveshje të pranueshme organizuam veprime të përshkallëzuara sindikale duke nisur me protestën e 8 prillit, grevën njëorëshe në tërë sistemin arsimor dhe në sektorët e tjerë, protestën e 20 majit me pjesëmarrje masive të anëtarësisë, për këto qeveria nuk qau kokën", ka thënë Jasharaj, duke shtuar se ka dërguar letra në secilën adresë institucionale për realizimin e kërkesave të SBASHK-ut. "Dërguam letra e lutje edhe te presidentja e kryeparlamentari, madje edhe te secili deputet. duke i lutur të angazhohen që të ketë dialog dhe marrëveshje. Shfrytëzuam edhe mundësinë e fundit për dialog, duke

angazhuar ndërmjetësuesin dhe i bëmë këto në përpjekje që të ndryshojë qasja e gabuar e qeverisë dhe që të mos kemi nevojë të shkojmë në grevë të përgjithshme, por qeveria i injoroi të gjitha këto, duke na sjellë në pozitë që të mos kemi më as mundësi të tjera dhe ne duhet ta respektojmë zërin e anëtarësisë dhe shkojmë në grevë të përgjithshme. Këto fakte që i përmendëm dhe shumë të tjera dëshmojnë se për këtë situatë të krijuar dhe për grevën që do të ndodhë në javën e fundit të gushtit. Nëse qeveria vazhdon me këtë qasje, atëherë greva do të vazhdojë edhe më 1 shtator e tutje derisa nuk realizohen kërkesat legjitime të punëtorëve arsimorë dhe të punëtorëve të tjerë në sektorin publik. Fajtorë e vetme është Qeveria e Kosovës", ka theksuar ai. Sipas Jasharajt, SBASHK-u dhe

sindikatat e tjera i kanë bërë të gjitha këto angazhime e veprime që të mos vijnë te greva e përgjithshme. "Qeveria nuk bëri asgjë përveç që vazhdoi qasjen e gabuar dhe injorimin e kërkesave të sindikatave. Aq më keq, qeveria vazhdon të lavdërohet se ka krijuar buxhetin më të madh të të gjitha kohëve, po ashtu edhe ekspertë të ekonomisë kritikuan se qeveria ka tepër shumë para, që i mban të palosura. Pra, ka mundësi e buxhet, por nuk do të plotësojë asnjë kërkesë të sindikatave dhe kështu sikur po na thotë të shkojmë në grevë të përgjithshme. Ministre, nëse ju dhe qeveria vërtet brengoseni për nxënësit dhe orët e ditët e humbura nga greva, angazhohuni dhe hapni dyert për takime e dialog dhe për gjetje të zgjidhjes së pranueshme për kërkesat e anëtarësisë", ka thënë Jasharaj.

KDI-ja: 23 komuna shënuan rritje të transparencës komunale

EPOKA
ERE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 2 GUSHT - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), në partneritet me konsorciumin e organizatave joqeveritare "Aleanca Qytetare për Transparencë", ka publikuar "Transparimet Komunal", në të cilin janë pasqyruar të gjeturat e nivelit të transparencës së institucioneve lokale për 38 komunat e Kosovës për periudhën janar - qershor 2022. Bazuar në të gjeturat gjatë e kësaj periudhe, komunat me nivelin më të lartë për përmbushjen e indikatorëve vlerësues janë: Komuna e Rahovecit me 83 pikë apo 94.32 për qind, komuna e Gjakovës me 80 pikë apo 90.9 për qind, komuna e Kamenicës dhe ajo e Mitrovicës së Jugut me

nga 78 pikë apo 88.63 për qind, komuna e Lipjanit, Pejës, Podujevës dhe Prishtinës me nga 77 pikë apo 87.5 për qind, komuna e Drenasit, Kaçanikut si dhe Prizrenit me nga 76 pikë apo 86.36 për qind. Ndërsa komunat që kanë treguar nivel më të ulët për përmbushjen e indikatorëve vlerësues janë: Komuna e Zveçanit dhe Klllokotit me nga 45 pikë apo 51.13 për qind, komuna e Fushë-Kosovës, Artanës,

Ranillugut, Parteshit si dhe Zubin Potokut me nga 44 pikë apo 50 për qind. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2021, gjatë kësaj periudhe janë 23 komuna të cilat kanë shënuar rritje për përmbushjen e indikatorëve vlerësues, dy komuna janë me pikë të njëjta në dy periudhat vlerësuese dhe 13 komuna kanë shënuar rënie në përmbushjen e transparencës komunale.

Krahasuar me periudhën e njëjtë të vlerësimit nga viti paraprak, komuna e Shtërpçës dhe ajo e Kamenicës mbeten ndër komunat të cilat kanë shënuar rritje më të madhe për përmbushjen e indikatorëve vlerësues në transparencën komunale. Komuna e Shtërpçës nga 62 pikë ka shënuar rritje për 22 pikë derisa komuna e Kamenicës nga 62 pikë, ka shënuar rritje për 18 pikë gjatë periudhës së njëjtë të vlerësimit janar - qershor 2022. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vlerësimit nga viti paraprak, komuna e Deçanit, e Skenderajt, e Fushë-Kosovës, e Hanit të Elezit, e Klinës, e Obiliqit dhe e Vushtrrisë mbeten ndër komunat të cilat kanë shënuar rënie më të madhe për përmbushjen e

indikatorëve vlerësues në transparencën komunale. Komuna e Deçanit, nga 64 pikë sa ishte e vlerësuar gjatë periudhës janar - qershor 2021, gjatë periudhës së njëjtë të vlerësimit për vitin 2022 ka shënuar rënie për 10 pikë, komuna e Skenderajt dhe Fushë-Kosovës kanë shënuar rënie 7 pikë, komuna e Hanit të Elezit, e Klinës dhe e Obiliqit kanë shënuar rënie me nga 6 pikë. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vlerësimit nga viti paraprak, komuna e Rahovecit dhe ajo e Malishevës mbeten ndër komunat të cilat kanë treguar rezultat të njëjtë, pa ndonjë rënie apo ngritje për përmbushjen e indikatorëve vlerësues në transparencën komunale.

Ministri Peci dhe ambasadori i Katarit bisedojnë për potencialin e zhvillimit të bujqësisë

PRISHTINË, 2 GUSHT (ER) - Ministri i Bujqësisë, Faton Peci, ka pritur në takim ambasadorin e Katarit në Shqipëri, jo rezident në Kosovë, Ali Bin Hamad Al Marri. Peci ka theksuar se me ambasadorin Al Marri kanë biseduar për potencialin e zhvillimit të bujqësisë dhe për mundësitë e investimeve të agrobizneseve

të Katarit në Kosovë. "Sot prita në takim ambasadorin e Shtetit të Katarit në Shqipëri, jorezident në Kosovë, Shkëlqesinë e tij, z. Ali Bin Hamad Al Marri. Me ambasadorin Al Marri biseduam për marrëdhëniet e shkëlqyera në mes të Kosovës dhe Katarit si dy vende mike për potencialin e zhvillimit të

bujqësisë dhe mundësitë e investimeve të agro-bizneseve të Katarit në vendin tonë. Shkëlqesinë e tij, ambasadorin Al Marri, e falënderova për mbështetjen e vazhdueshme që Katarit i ka dhënë Kosovës në shumë fusha, që nga vendosja e marrëdhënieve miqësore e diplomatike mes dy vendeve tona", ka thënë Peci.



Kujdes, nuk kemi nevojë për "tokë të djegur"

Shkruan:
Prof. Imer RUSINOVC

Toka bujqësore është çelësi i suksesit të çdo ferme bujqësore e cila duhet të shfrytëzohet përmes menaxhimit të duhur dhe të kujdesshëm agronomik. Nëse i ndizni hamulloret dhe mbetjet organike, do të jeni armiku më i madh i prodhimeve bujqësore, duke e shkatërruar mikroflorën dhe faunën në pjesën e shtresës punuese, me ç'rast humbni masën organike e cila mund të transformohet në asimilate bimore.

Ndezja e hamulloreve (kashtës) pas përfundimit të korrje-shirjeve është rruga dhe mënyra më e keqe e mundshme për fermerë të vyer. Ndezja e hamulloreve rrezikon jetën dhe



pronën e njerëzve. Kujdesuni për veten dhe tokën tuaj, nëse dëshironi që e njëjta t'ju jap më shumë prodhime në vazhdimësi. Organizmat në tokë duhet të jenë

në ekuilibër, të cilin balancë e kemi goxha shqetësues si pasojë e përdorimit të kimikaleve, andaj është e rëndësishme të jetojnë mikroorganizmat që t'i

zbërthejnë (mineralizojnë) lëndët organike në çdo tip të tokës, t'i shndërrojnë përbërjet organike në ato humike, të formojnë dhe mirëmbajnë poret e tokës (për furnizimin me ujë dhe oksigjen). Vetëm kështu "zinxhiri ushqimor" mund të jetë funksional.

Kashta përfaqëson një lloj plehu organik, andaj të njëjtën përmbyseni (lëvrojeni) që t'u nënshtrohet dekompozimeve në tokë, mundësisht me një sasi të Uresë (46 për qind azot) për t'u harmonizuar raportit i karbonit (C) i cili dominon në kashtë me azotin e dhenë me Ure, për zberthim më efikas. Sot shumë pak lëndë organike kthehet në tokë, si pasojë e mungesës së plehut të stallës. Raporti i kashtë:kokërr sillet 1:1 dhe kalkulimet agronomike

tregojnë se me djegiet e hamulloreve apo mbetjeve organike humbet 5-7 tonë lëndë organike për hektar. Mos i ndizni hamullorët dhe mbetjet organike pas korrjeve, sepse duke vepruar kështu shkaktohen dëme afatgjatë dhe të pakthyeshme mjedisore në tokë dhe mjedis. Latinët e vjetër patën thënë "zjarri është një shërbëtor i mirë, por një mjeshtër i keq", andaj mos i ndizni hamullorët që të jeni zotërues të mirë ndaj tokës bujqësore, e cila na ushqen vazhdimisht.

Fermerë të respektuar, ju jeni shtresa më e shenjtë e shoqërisë për qëllimet tuaja humane (prodhimi i ushqimit), andaj ju rekomandoj që të mos i digjni hamullorët dhe t'a menaxhoni tokën bujqësore siç duhet!

Gjashtëfishimi i subvencioneve për ndërmarrjet publike, Hoti: Po përdoren për largimin e punëtorëve nga puna



PRISHTINË, 2 GUSHT (ER) - Ish-kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka publikuar një statistikë të gjashtëmujorit të parë të këtij viti, që reflekton rritje të subvencioneve për ndërmarrjet publike gjashtë herë më shumë sesa në vitin e kaluar.

Hoti këtë statistikë në formë infografike e ka publikuar në "Facebook" ku, sipas tij, vlera e subvencioneve në ndërmarrje publike në gjashtëmujorin e parë ka shkuar në 12.39 milionë euro.

"Çudi me këtë qeveri. E ka ndaluar 'gjakderdhjen financiare' të ndërmarrjeve publike, por për periudhën

janar-qershor 2022 i ka rritur për gjashtë herë subvencionet nga buxheti për këto ndërmarrje, nga 1.92 milion euro më 2021, në 12.39 milionë euro sivjet", ka shkruar Hoti. Më tutje, Hoti ka thënë se subvencionet janë duke u përdorur nga qeveria për largim të punëtorëve nga puna. "Me gjasë, një pjesë e konsiderueshme e këtyre mjeteve po shkojnë për të larguar punëtorë nga puna në Telekom përmes skemës së pensionimit të parakohshëm, duke ua paguar përmjetherë 24 paga mujore atyre që lëshojnë punën. Fatkeqësisht, kjo skemë po rezulton me ikje të kuadrove

më të mira nga Telekom, pasi kuadrot më të mira kanë më shumë alternativa në treg. E vërteta është, fatkeqësisht, se taksat e qytetarëve po përdoren për të larguar punëtorë nga puna. Duket se 'gjakderdhja financiare' – ky term morbid që u fut në diskursin politik – po i ndodh buxhetit të shtetit me vendime qeveritare. Duke qenë se Telekomit po i ikin kuadrot, detyrimisht do të detyrohet të rekrutojë punëtorë së shpejti. A nënkupton kjo se po largohen punëtorët ekzistues për t'u zëvendësuar me të tjerë nga partia në pushtet?! Çfarë politike e mbrapshtë është kjo?!", ka shkruar Hoti.

Tahiri: Qeveria vendos ta shuajë Agjencinë për efikasitet të energjisë

PRISHTINË, 2 GUSHT (ER) - Shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Besnik Tahiri, ka bërë me dije se Qeveria e Kosovës ka vendosur ta shuajë Agjencinë për Efikasitet të Energjisë. Sipas Tahirit, ky është një vendim absurd në kohën kur e gjithë bota po angazhohet për efikasitet dhe bën programe specifike në këtë drejtim. "Edhe një vendim absurd.

Qeveria vendos ta shuajë Agjencinë për Efikasitet të Energjisë. Në kohën kur i gjithë globi po angazhohet për efikasitetin e energjisë dhe bën programe specifike në këtë temë, Qeveria e Kosovës sot ka sjellë një ligj për racionalizimin e agjencive, ku rekomandon që të shuhet Agjencia për Efikasitet të Energjisë", ka shkruar Tahiri në "Facebook". Ai ka thënë se qeveria e vendit

duhet të diskutojë për rikthimin e Ministrisë së Energjisë e lëre më të shuhet një agjenci. "Kundërthënia bëhet edhe më e madhe, ngaqë e gjithë agjenda e qeverisë lidhet me konceptin e efikasitetit. A mund të tregojë dikush se si është e mundur të ndodhë një gjë e tillë, në veçanti, duke e ditur se kriza energjetike dhe koncepti i energjetikës është kah thellohet. Vendet përkatëse

kanë paraqitur masat e subvencionimit, nisur nga pajisjet eficiente të ngrohjes, lëndëve djegëse, ulja 3-4 gradë e temperaturave në Austri në rrjetet e ngrohjes qendrore e deri te ndërrimi i shiritave izolues të deryve dhe dritareve. Në esencë, qeveria e vendit duhet të diskutojë për rikthimin e Ministrisë së Energjisë e lëre më të shuhet një agjenci që qëllim të vetëm ka efikasitetin e



energjisë. Në Komisionin për Administratë Publike e kundërshtova këtë ligj", ka shkruar ai.

Serbia nuk e ka për qëllim vetëm veriun e Kosovës!



**Behxhet Sh. SHALA -
BAJGORA**

Dështim i intervenimit, fitore e Vuçiqit: Qeveria e Kosovës kishte paralajmëruar, pa lënë asnjë mëdyshje, se nga data 1 gushti 2022 do ta fillojë zbatimin e reciprocitetit për qytetarët që kishin dokumentet e Serbisë duke lëshuar leje hyrje dhe daljeje në pikat kufitare me këtë shtet, që as nuk e njeh Kosovën si shtet dhe që përpiket, duke e bërë jofunksional, ta shkatërrojë atë. Serbia asnjëherë nuk i ka pranuar dokumentet e lëshuara nga Kosova dhe, gjatë hyrjes në këtë shtet, ua ka lëshuar një leje hyrjeje për një kohë të caktuar. Gjithashtu, Qeveria e Kosovës ka vendosur t'i zëvendësojë tabelat e mëparshme me tabela RKS dhe për këtë ka qenë një fushatë disamujore si dhe premtime se do të lirohen nga pagesa gjatë regjistrimit të automjeteve. Po të njëjtën kohë Qeveria e Serbisë ka kundërshtuar vendimin e Qeverisë së Kosovës duke riaktivizuar instrumentalizimin e strukturave paralele serbe. Skenari ishte grumbullimi i serbëve të veriut pas sirenavë për alarm dhe bllokimi i rrugëve kryesore për ta pamundësuar lëvizjen e qytetarëve dhe të Policisë së Kosovës e që, së paku deri më tani, është treguar e suksesshme në masën thuaja 100 për qind. Pastaj, me ndihmën e faktorit ndërkombëtar, kryesisht të ambasadorit të Amelikës, janë bërë përpjekje të rikthehet normaliteti përmes një kompromisi të padinjatshëm për një shtet, ju hiqni barrikadat, ndërsa ne e tërheqim policinë! Madje kishte situata të rënda kur policia mbahej peng e bllokuar nga forcat paramilitare dhe bisedimet bëheshin që të sigurohen kushtet për tërheqjen e tyre duke i fyer rëndë në baza kombëtare, me familje etj. Policia nuk kishte të drejtë të përdorte armën e që, në këtë rast, ia mundëson ligji. Edhe gjatë intervenimit të fundit Policia e Kosovës ishte në situatë të njëjtë, u desh të dërgohen dy autobllinda për ta

mundësuar kthimin e tyre. Se kush ka vendosur për këtë intervenim të papërgjegjshëm, të tillë ishin edhe intervenimet e mëparshme, nuk dihet ende! Opozita po e akuzon pozitën se ka intervenuar pa koordinim me ndërkombëtarët ose, më mirë të themi, pa u koordinuar me Ambasadën e Amelikës në Prishtinë. Tash ambasadori thotë se ka pasur koordinim e që nuk është pritur deklarim tjetër përveç nëse kanë vendosur që kryeministrin Kurti ta dërgojnë në pushim të përhershëm në Santorini, Shtojë apo fjordet e Norvegjisë. Po duket se ndërkombëtarët kanë vendosur ta luajnë lojën deri në fund me Albin Kurtin për faktin se ia kanë zbutur aq shumë imunitetin ndaj kundërshtimit sa që nuk kanë nevojë për tjetër lojtar. Realisht, Albin Kurti si pushtetar nuk është as hije e zbehtë e Albinut opozitar. Është i dorëzuar fare dhe, në rrethanat ekzistuese, në asnjë mënyrë nuk do ta dorëzojë pushtetin sepse është bindur se të qenit në pushtet dhe i pushtetshëm nuk qenka aspak keq, përkundrazi. Dihet mirëfilli se politika dhe politikanë, sidomos në Ballkan, me të ardhur në pushtet, operohen nga përgjegjësia dhe skuqja e fytyrës, përjashtuar rastin kur i ekspozohen diellit më shumë se që duhet. Marrja, si kategori morale, i adresohet opozitës sikur edhe të gjitha dukuritë e tjera negative. Tash pas këtij dështimi total dhe kolosal të intervenimit, si të gjitha intervenimet e mëparshme, ambasadori i Amelikës i nxori Kurtit dhe qeverisë së tij, një muaj besë, deri më 1 shtator. Ambasadori i Amelikës duket se është njohës i mirë i Kanunit të Lekë Dukagjinit sepse kanunçe edhe ka marrë vendim. Kryeministri Kurti, i gjetur para një situatë thuaja pa zgjidhje, botërisht e falënderoi ambasadorin e Amelikës, kurse Vojsa Osmani, si faktor përcaktues për zgjidhjen e të gjitha problemeve të botës, kërkon që BE-ja t'i vendosë sanksione Vuçiqit në kohën kur kryetari i Serbisë po i gëzon të gjitha privilegjet pikërisht nga kjo BE. Se kush u nda krejtësisht i lagur e ceka më lart por, pse Vuçiqi e arriti një fitore të pastër, me mjete krejtësisht të ndyra politike dhe paramilitare?! Vuçiqi tërë lojën po e luan në territor të Kosovës, Serbia po

mbetet e paprekur. Po flitet për kompromis të dhimbshëm që i drejtohet ekskluzivisht Kosovës, Serbia vetëm fiton qoftë nëse e merr edhe një dru të vetëm nga Kosova! Me para të buxhetit të Kosovës po paguhen paramilitarët politikë të Listës Serbe, me vojvodën Goran Rakiqin, në krye. Po iu paguhen të gjitha shpenzimet si rryma, uji, mbeturinat, nuk e paguajnë as tatimin në pronë, shteti i Kosovës ka paguar dhe po paguan rebelimin e këtyre njësiteve çetnike të Serbisë në Kosovë. Realisht, veriu i Kosovës nuk kontrollohet nga Kosova, aty është Serbia që është përcaktuese për këtë pjesë të okupuar të Kosovës, me ndihmën e ndërkombëtarëve, pa asnjë dyshim. Serbët e instrumentalizuar vullnetarisht, kur të duan dalin nga institucionet e Kosovës, kur të duan kthehen mirëpo pagat i marrin me rregull, sikur të ishin qytetarët më besnikë të Kosovës! Paramilitarët e Serbisë në Kosovë dhe vet Serbia po e mbajnë peng Kosovën duke e penguar ta shtrijë sovranitetin në kufijë të integritetit territorial duke e përdorur ligjin dhe detyrimet kushtetuese. Tash, në këto rrethana dhe në këto mundësi duhet të kërkohet një zgjidhje, aspak e mirë për Kosovën dhe, ndonëse shumë e mirë për Serbinë, ajo nuk e do as këtë zgjidhje.

A kërcënohemi nga një luftë me Serbinë: Bashkësia ndërkombëtare po e përdorë Serbinë si gogol kërcënimi ndaj Kosovës dhe disiplinim të politikanëve të pabindur. Si armë të fuqishme, në këtë drejtim po e përdorë Gjykatën Raciste Speciale në Hagë. Një luftë eventuale me Serbinë, unë besoj se nuk do të ketë luftë, më shumë i konvenon Kosovës se Serbisë. Përveç retorikes luftënxitëse, Serbia nuk ka kapacitet ta pushtojë e lëre më ta mbajë nën pushtim Kosovën. Në një konflikt eventuale, më nuk do të kishte luftë vetëm midis Serbisë dhe Kosovës por do të ishte luftë e serbëve kundër shqiptarëve. Janë provuar luftërat lokale dhe ato kanë prodhuar një situatë që e kemi sot, duke mos i zgjidhur problemet por i ka konservuar ato. Kjo është edhe taktikë e faktorit vendimmarrës ndërkombëtar; duke mirëmbajtur paqen e brishtë, imponojnë zgjidhje të përhershme politike sipas ligjit të të fortit. Në një luftë eventuale do të ishin përballë

6 milionë serbë, me 8 milionë shqiptarë. Kjo nënkupton se do ta kishim një situatë krejtësisht ndryshe krahasuar me luftën e fundit. Në Kosovë aktualisht janë mbi 10 000 policë të trajnuar mirë dhe të motivuar sikur edhe mbi 8 000 ushtarë. Pastaj, territori i Ballkanit është pjesë integrale e Evropës dhe, askush normalë nuk do të lejonte hapjen e zjarrit i cili nuk do të kishte mundësi të lokalizohej. Lufta eventuale, për të cilën nuk besoj se do të ndodhë, në mënyrë të drejtpërdrejtë do të prekte Kosovën, Shqipërinë, Serbinë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, Bosnje dhe Hercegovinën, Greqinë dhe Bullgarinë. Pasoja do të ishin të paimaginueshme. Serbia e di këtë dhe vështirë do t'i hynte kësaj aventure që përfundimisht këtë shtet do ta kthente në kufijtë e Pashallëkut të Beogradit. Jam i bindur se, edhe nëse Serbisë i jipet pjesa më e madhe e veriut të Kosovës, Serbia nuk do të pranonte që Marrëveshja të përfshijë edhe njohjen reciproke. Serbia e kontrollon veriun si dhe zonat e mbrojtura brenda Kosovës. Me një marrëveshje eventuale Serbia e humbë mundësinë e mbajtjes nën presion të Kosovës në një periudhë afatgjate prandaj është kundër çdo marrëveshje. Mirëpo, Vuçiqi po e luan mirë lojën politike duke u ofruar si njeri i paqes po që, Albin Kurti po i prishë të gjitha mundësitë për marrëveshje. Politikë tipike bizantine por mirë e pranuar dhe e integruar në politikën evropiane. Bashkësia ndërkombëtare, midis kërkesës së drejtë të Kosovës që të ushtrojë të gjitha përgjegjësitë shtetërore në territorin e saj dhe kërkesës së Serbisë që të rikthejë politiken e Millosheviqit përmes riinkarnimit shumë original në formën dhe përmbajtjen e Aleksandër Vuçiqit, do të ofrojë një zgjidhje të ndërmjetme e cila, në një formë apo tjetër do të mbajë të lidhura Serbinë dhe Kosovën dhe, e cila do të duket në vija më të qarta pas 20 vjetëve, ta zëmë. Nëse veriun e Kosovës, të spastruar nga shqiptarët lejon të aneksohet nga Serbia atëherë duket si utopike mbijetesa e serbëve brenda pjesës tjetër të Kosovës, edhe në rrethana të një demokracie të konsoliduar. Nuk është halli i Serbisë se çka do të bëhet me serbët e Kosovës por si do ta

mbajë Kosovën nën presion për një kohë të gjatë, në përpjekje ta shndërrojë në gjendje të përhershme. Albin Kurti aspak nuk e ka problem ta pranojë Zajebnicën, Manastirin e Deçanit dhe të tjera për faktin e i ka të trashëguara. Në rrethana normale kjo do të ishte çështje teknike mirëpo duhet ta kemi të qartë se Albin Kurti të gjitha çështjet politike dhe jopolitike, në 15 vjetët e fundit i ka ndërtaur mbi themelet e kundërshtimit të Zajebnicës dhe parullave, Jo Negociata, Vetëvendosje. Tash, këto kundërshtime po i përdorë për blerje të kohës, ndryshe mendoj se nuk do ta kundërshtojë asnjë marrëveshje. Nëse i kundërshton këto marrëveshje, si do të pinte pastaj kafe me ambasadorin e Amelikës?! Për këtë arsye mendoj se nuk do të ketë zgjedhje në vjeshtë përveç se nëse këtë nuk e imponojnë ndërkombëtarët. Opozita e Kosovës është aq paqësore sa që e turpërojnë edhe Gandin që preferonte një kundërshtim aktiv dhe Rugovën që nuk ofronte kurrfarë kundërshtimi. Prandaj përpjekja e ndërkombëtarëve do të shkojë në drejtim të përfshirjes së sa më shumë subjekteve politike në marrëveshjet eventuale për faktin se nuk lejojnë që vetëm një subjekt politikë të vë firmën në marrëveshje për Kosovën. Faktori ndërkombëtar nuk e ka aspak problem ta bindë opozitën, me një kafe 30 centë në Kuvendin e Kosovës për një numër të caktuar, me një kafe të mëngjesit në ambasada për ata me një k..e dhe me një biletë për pushime afatgjata në qytetin pitoresk të Hagës, për ata që kanë k..e, në kuptimin e plotë të fjalës . K...mëdhenjtë janë veç në Hagë dhe po mbahen pengje. Krahasuar me Grenellin që mercenarizmin për Serbinë më nuk po e mban fare të fshehur, mercenarët kosovarë janë më diskretë, deri në kohën kur do të duhet t'i ulin brekushet! E kam edhe një shkrim tjetër të papërfunduar me titullin: "A mund të ndodhë që në qeverinë Kurti, Veton Surroi dhe Blerim Reka të mos jenë pjesë e grazhdit ...". Nëse më kthehet guximi, do ta përfundojë, nëse më forcohet frika, asgjë. Frika është njerëzore, në fund të fundit!

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Kosova U18 regjistron humbjen e katërt



PRISHTINË, 2 GUSHT - Kosova është mundur nga Norvegjia me rezultat 59:50 (13:13, 16:10, 14:10, 16:17) në FIBA Kampionatin Evropian, Divizioni B për meshkuj U18. Kjo ishte humbja e katërt në katër ndeshje të zhvilluara. Fillimi i ndeshjes ishte i barabartë, ku asnjëra nuk arrinte të shkëputej në rezultat

dhe kjo periudhë përfundoi 13:13. Lojë e ngjashme u zhvillua edhe në periudhën e dytë, por në fund të kësaj pjese norvegjezët hynë në një seri të suksesshme dhe shkuan në pushim me rezultat 29:26. Edhe në periodën e tretë u shënuan shumë pak pikë, ku Dardanët tentuan, por nuk arritën të rikthehen, ndërsa shifrat në

semafor pas 30 minutash ishin 43:33. Në çerekun e fundit basketbollistët u afruan në pesë pikë, 57:52, por nuk arritën të bëjnë më shumë, duke pësuar 59:50. Te Kosova u dallua Bardh Istrefi me 20 pikë e 11 kërcime. Dardanët ndeshjen e fundit në grupe e zhvillojnë sot (e mërkurë) ndaj Bosnjë-Hercegovinës.

Drita, skuadra më e vlefshme në Kosovë



PRISHTINË, 2 GUSHT - Skuadra e Dritës vazhdon të jetë në krye të elitës së futbollit të Kosovës, duke u renditur në vendin e parë sa i përket vlerës së skuadrës me plot 4.48 milionë euro sipas faqes "transfermarkt". Jo vetëm vlera e klubit, Drita ka skuadrën e dytë më të re në kampionat, vetëm Trepça '89 ka momentalisht skuadër më të re me moshën

mesatare 22.3. Minatorët, të cilët u rikthyen këtë vit në Superligën e Kosovës, siç duket nuk e kanë ndryshuar aspak filozofinë e klubit. Dy lojtarët më të vlefshëm te klubi bardhekaltër janë Marko Simonovski dhe Rron Broja. Dyshja në fjalë vlerësohen 325.000 euro, ndërsa menjëherë pas tyre është kapiteni Ardian Limani me 300 000 euro në tregun e

transferimeve. Kjo është hera e parë për tre herë kampionët e Kosovës të cilët janë afër vlerës pesë milionë euro, të cilën asnjë skuadër e Kosovës nuk e ka arritur një gjë të tillë deri më tani. Pas Dritës, renditet skuadra e Ballkanit me 4.05 milionë, pas kampionëve në fuqi renditet Llapi me 3.23 milionë dhe në vendin e katërt është Gjilani me 2.80 milionë.

SHKURT

Nuza ndan drejtësinë në ndeshjen e Ligës së Konferencës

Ndeshja e rrethit të tretë në Ligën e Konferencës, RFS – Hibernians, do të drejtohet nga gjyqtarët e Kosovës. Është Genc Nuza ai që do ta ndajë drejtësinë në këtë duel, e të cilit do t'i asistojnë Fatlum Berisha dhe Bujar Selimaj, teksa gjyqtar i katërt do të jetë Mervan Bejtullahu. Ky takim zhvillohet të enjten në orën 18:00 në Letoni. Delegimi nga UEFA në këtë fazë të garave është një vlerësim i madh që u bëhet gjyqtarëve tanë, të cilët dita-ditës po dëshmojnë gjithnjë e më shumë kualitetin e tyre në ndarjen e drejtësisë.

Ballkani mund të luajë në 'play-off' ndaj Shkupit

Skuadra e Shkupit mund të jetë kundërshtarja e mundshme e Ballkanit në "play-off"-in e Ligës së Konferencës. Në rast se Ballkani mposht Klaksvikun dhe kalon tutje, atëherë në fazën e "play-off"-it do të përballet me humbësin e ndeshjes mes Shamrock Roversit dhe Shkupit. Ballkani të enjten do ta zhvillojë ndeshjen e parë kundër skuadrës nga Ishujt Farore në stadiumin "Fadil Vokrri".

Red Bulli rinovon marrëveshjen me Hondan

Skuadra e Red Bullit në Formula 1 ka vazhduar marrëveshjen me Hondan. Kompania e Hondas është ajo që përkujdeset për fuqinë e motorit të bolidit të Red Bullit në Formula 1 dhe kështu do të jetë edhe për disa vjet. Red Bull dhe Honda do të jenë në bashkëpunim deri në vitin 2025. Të dyja palët janë të kënaqura me rezultatet në Formula 1 për sezonin 2022, ku Red Bulli po prin në nivel konstruktorësh dhe me pilotin. Lajmin për rinovimin e marrëveshjes e ka dhënë faqja zyrtare e Red Bullit.

KB Prishtina përforcohet me Kakrukin

KB Prishtina ka njoftuar se ka nënshkruar me talentin nga Maqedonia e Veriut, Valmir Kakruki. Ky i fundit pati një sezon të suksesshëm në elitën maqedonase me KK Rabotnickin, ku në 32 ndeshje pati mesatare prej 10.2 pikë, 5.7 kërcime dhe 0.5 bllokada për ndeshje. "Valmir Kakruki (205 cm), 21-vjeçar, i lindur në Maqedoni Veriore, vjen pas një sezoni të suksesshëm në elitën maqedonase me KK Rabotnicki, ku në 32 ndeshje pati mesatare prej 10.2 pikësh, 5.8 kërcime dhe 0.5 bllokada për ndeshje", thuhet në njoftim.

Kakruki ka qenë rregullisht pjesë edhe e grupmoshave të reja U16, U18 dhe U20 në Kombëtaren e Maqedonisë së Veriut. Më herët ka luajtur për KK Vardar, KK Akademija FMP dhe për KK MZT Skopje U19 në Junior ABA LIGA. Sigal Prishtina i beson potencialit të tij dhe shpreson se t'i shërbejë si "trampolinë" për karrierën e tij.

LeBron, i lumtur te LA Lakers

LOS ANXHELOS, 2 GUSHT - LeBron James ka ende edhe një vit kontratë me skuadrën e Lakersat dhe, sipas medieve amerikane, ai do ta respektojë atë. Madje "king James" është i lumtur në Los Anxhelos, ku

do të vijojë të qëndrojë e të jetojë edhe më pas. Sipas medieve, ai mund të largohet nga Lakersat vetëm në vitin 2024, kur djali i tij i madh Broony do të mund të zgjidhet në "draft" dhe të ketë mundësi

të luajë në NBA. LeBron edhe verën e ardhshme mund të rinovojë për një vit kontratën me Lakersat, duke qenë se ka të drejtën e opsionit të lojtarit. Në rast se ndodh kjo, pas një viti, ai do të arkëtojë 46.7

milionë dollarë nga kontrata e re. Rregullat e reja të NBA-së nuk lejojnë lojtarët mbi 38 vjeç, moshë që mbush James në dhjetor, të firmosin kontrata më shumë se dyvjeçare.



Kosovare Asllani përfshihet në ekipin më të mirë të 'Euro 2022'

LONDER, 2 GUSHT - Kampionati Evropian i Femrave përfundoi të dielën me triumfin e Anglisë kundër Gjermanisë. Ishte një fund i mrekullueshëm i një muaji të shkëlqyer me futboll, në të cilin yjet ndoshta nuk ishin ato që prisnin më shumë. Mediumi sportiv "Goal" e ka zgjedhur formacionin më të mirë. Futbollistja kosovare kishte paraqitje fantastike, duke e

ndihmuar Suedinë që të arrinte deri në gjysmëfinale. "Çdo kundërshtarë që del kundër Kosovare Asllanit di gjithçka për talentin e saj dhe çfarë mund të bëjë, por kjo nuk e bën më të lehtë që ta ndalojë atë. Asllani e drejtoi Suedinë deri në gjysmëfinale, duke u renditur e treta për rastet e krijuara, e dyta për asistime, e treta për driblime të përfunduara dhe e dyta për

faulet e fituara", shkruan "Goal" për paraqitjet e Asllanit. "Futbollistet me aftësitë e saj shihen shpesh si lojtare luksi, por Asllani ka një ritëm pune dhe disiplinë që është jashtëzakonisht e rrallë në pozicionin e saj. Asnjë lojtare nuk e fitoi topin në të tretën e fundit më shumë në Euro, me inteligjencën e saj taktike integrale në presionin e ekipit të saj".



Lewandowski: Vështirë të largohesha nga Bayerni

BARCELONË, 23 GUSHT - Robert Lewandowski e ka nisur këtë javë duke u kthyer në Gjermani për t'i thënë lamtumirë Bayern Munchenit, duke takuar punonjës të ndryshëm të klubit për t'i falënderuar për mbështetjen e tyre gjatë tetë vjetëve të tij në "Bavari". Sulmuesi polak nuk u largua me kushtet më të mira, pasi kishte shtyrë për një transferim te Barcelona edhe pse i kishte mbetur edhe një vit nga kontrata e tij me klubin gjerman. "Isha i trishtuar dhe në një situatë të vështirë", ka thënë sulmuesi polak për "Sky Sports" gjatë vizitës së tij në Munchen. "Do të jem gjithmonë mirënjohës për atë që fitova dhe përjetova këtu. I kam falënderuar të gjithë për atë që kanë bërë për mua dhe u kam dhënë dhurata. Ka qenë



emocionale dhe e vështirë. Javët e fundit ishin të vështira për të gjithë, por nuk do ta harroj kurrë atë që kisha këtu dhe i falënderoj

tifozët për mbështetjen. Tani mund të largohem me ndërgjegje të pastër", ka shtuar Lewandowski.

SHKURT

KB Bashkimi rikthen Ballukun

Arion Balluku është rikthyer sërish te klubi i Superligës së Kosovës në basketboll, KB Bashkimi. Lajmin e ka dhënë klubi prizrenas në faqen zyrtare. Balluku ishte pjesë e Bashkimit edhe në vitin 2018 kur Bashkimi u shpall kampion i Kosovës. "Klubi ynë ka arritur marrëveshje me Arion Ballukun i cili ka qenë pjesë e ekipit kampion në sezonin 2018", thuhet në njoftim e klubit prizrenas.

Lazio e largon falas Hysajn

Lazio ka kryer shtatë transferime në këtë afat kalimtar, derisa trajneri Sarri ka kërkuar edhe një mbrojtës të majtë. Sipas "Corriere dello Sport", Elseid Hysaj është i sakrifikuari i parë, pasi anësori kuqezi nuk bën më pjesë në planet e trajnerit. Lazio është gati ta lë të lirë mbrojtësin kuqezi në mënyrë që të lirohet nga paga e tij. Hysaj mund t'i bashkohet Gennaro Gattusos te Valencia.

Leipzig kërkon rikthimin e Wernerit


Sipas raportimeve nga "Sky Deutschland", Timo Werner është gati të kthehet te Leipzig. Media gjermane flet për negociatat mes klubeve që po ecin me shpejtësi dhe nuk përjashtohet mundësia që lojtari të transferohet në formën e thjeshtë të huazimit. 26-vjeçari u ble nga Chelsea për 53 milionë euro, por kontributi i tij ishte jo ai që pritej, vetëm 23 gola në 89 ndeshje.

Roma, afër transferimit të Belottit


AS Roma pritet të jetë një nga skuadrat më serioze në Serinë A këtë sezon. "Giallorossi" raportohet të ketë arritur marrëveshje me yllin e Torinos, Andrea Belotti. "La Repubblica" shkruan se skuadra romake pritet t'i paguajë 3.2 milionë euro për kartonin e italianit. Nëse palët merren vesh për çmimin e kartonit, Roma do t'i japë lojtarit një kontratë trevjeçare. Përveç Belotti, Roma po punon fuqishëm edhe në pistën Georginio Wijnaldum.

Nice konfirmon transferimin e Ramseyt

Aaron Ramsey do ta vazhdojë karrierën në Ligën 1. Ylli uellsian Ramsey është transferuar te skuadra e Nices. Mesfushori ishte lojtar i lirë, pasi arriti marrëveshje për shkëputjen e kontratës me skuadrën e Juventusit. Ramsey tani do të luajë në Ligën 1. Mesfushori ishte në kërkim të minutave para Kupës së Botës dhe te skuadra e re pritet t'i ketë ato. Lajmin për transferimin e lojtarit e ka dhënë faqja zyrtare e Nices.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA –SUHAREKË
OPSTINE SUVA REKA
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA



Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
06-Nr- 912
Me datë : 02.08.2022
Në bazë të nenit 8 të pika 1 dhev 2 Ligjit të punës Nr-03/L-212 dhe sipas Autorizimit të Kryetarit të Komunës 01- Nr- 016-45309 datë : 26.07.2022 , Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale shpallë këtë:

KONKURS

1. Një mami medicinale (moter akusherike) në QKMF- në Suharekë në repartin e Gjinekologjisë me kohë të pa caktuar

Përshkrimi i punëve dhe detyrave të punës :
- Udhëheq drejtpërdrejt me lehonën duke përfshirë vizitën, pregaditjen e shtatzënës për lindje

- Kujdeset për shëndetin e nënës dhe të posalindurit pas procesit të lindjes
- Kujdeset për dhënjën e terapisë dhe këshillave të mjekut specialist
- Mban evidencë në librin e lindjeve, vaksinon të posalindurit me vaksinë të BCG
- Kujdeset për aparaturën dhe mjetet gjinekologjike
- Udhëheq me ditarin e punës ditore të vizitave specialiste
- Respekton kriteret etike dhe profesionale në punë,
- Dhe punët tjera të dhëna nga udhëheqësi

Orari i punës: 1 Plotë:


Koeficienti sipas listës së pagës H-68,H- 377/1

Kohëzgjatje e kontratës : Gjashtë(6) muaj punë provuese me mundësi vazhdimi.
Dokumentet e nevojshme:
- Diplomën përkatëse mbi shkollimin e kryer
- Vërtetimin mbi praktikën profesionale – përvojën
- Certifikatën e lindjes
- Fotokopjen e Letërnjoftimit
- Certifikatën e gjendjes shëndetësore
- Licenca e punës
- Certifikatën që ndaj tij/ asaj nuk zbatohen hetimet


Komuna e Suharekës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Aplikacionet e pa kompletuara sipas kushteve të konkursit si dhe ato që arrijn pas afatit nuk do të merren në shqyrtim. Të interesuarit formularin e kërkesës për punësim mund t'a marrin në Drejtorinë Komunale të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (të Parku i qytetit) në Suharekë.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë pas shpalljes në mjetet e përditshme informative.

Drejtoria për Shëndetësi dhe M.Sociale
Ma.Sc. Besa KUQI



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA –SUHAREKË
OPSTINE SUVA REKA
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA



Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
06-Nr- 913
Me datë 02.08.2022
Në bazë të nenit 8 të pika 1 dhev 2 Ligjit të punës Nr-03/L-212 dhe sipas Autorizimit të Kryetarit të Komunës 01- Nr- 016-45309 datë : 26.07.2022 , Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale shpallë këtë:

KONKURS

1. Dy (2) teknik/e medicinal (infermier / e) në QKMF- në Suharekë me kohë të pa caktuar


Numri i Referencës: 06- Nr- 769
Përshkrimi i punëve dhe detyrave të punës : për pozitën 1
- Të ofroj ndihmën e parë dhe kujdesin tekniko fizik për pacientët
- Regjistrimi i te dhenave ne librin e protokollit dhe fletëzën kompjuterike
- Sigurimi i përkrahjes për pacientët
- Ekzaminimi dhe performanca në shërimin e pacientëve
- Dhënia e terapisë dhe këshillave për pacientët.
- Respektimi i orarit të punës
- Respektimi i kriterëve etike dhe profesionale në punë
- Dhe punët tjera të dhëna nga udhëheqësi konform ligjeve dhe rregulloreve në fuqi .

Orari i punës: 1 Plotë:
Koeficienti sipas listës së pagës H-68,H- 377/1
Kohëzgjatje e kontratës : Gjashtë(6) muaj punë provuese me mundësi vazhdimi.
Dokumentet e nevojshme:
- Diplomën përkatëse mbi shkollimin e kryer
- Vërtetimin mbi praktikën profesionale – përvojën
- Certifikatën e lindjes
- Fotokopjen e Letërnjoftimit
- Certifikatën e gjendjes shëndetësore
- Licenca e punës
- Certifikatën që ndaj tij/ asaj nuk zbatohen hetimet


Komuna e Suharekës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Aplikacionet e pa kompletuara sipas kushteve të konkursit si dhe ato që arrijn pas afatit nuk do të merren në shqyrtim. Të interesuarit formularin e kërkesës për punësim mund t'a marrin në Drejtorinë Komunale të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (të Parku i qytetit) në Suharekë .

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë pas shpalljes në mjetet e përditshme informative.

Drejtoria për Shëndetësi dhe M.Sociale
Ma.Sc. Besa KUQI



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA –SUHAREKË
OPSTINE SUVA REKA
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA



Direkcija za Zdravstvo i Socijalnu Dobrobit
06. Br. 912
Datum: 02.08.2022
Na osnovu člana 8, tacka 1 i 2 ,Zakona o radu Br-03/L-212 , i ovlašćenjem Predsednika Opštine 01- br- 016-29094 dana : 26.07.2022, Direktor/ka Direkcije objavljuje sledeći:

KONKURS

1. Medicinska babica (akušer) na GCPZ u Suvoj Reci, na odeljenju za Ginekologiju na neodređeno vreme

Opis poslova i zadatata:

- Direktno upravlja porođiljom, uključujući posetu, pripremu trudnice za porođaj
- Vodi računa o zdravlju majke i novorođenčeta nakon procesa porođaja
- Vodi računa o davanju terapije i savetima lekara specijaliste
- Vodi evidenciju u matičnoj knjizi rođenih, vakciniše novorođenčad BCG vakcinom
- Stara se o ginekološkoj opremi i alatima
- Vodi dnevnik rada specijalističkih poseta
- Poštuje etičke i profesionalne kriterijume na poslu,
- I ostale zadatke koje mu postavlja pretpostavljeni

Radno vreme: Puno radno vreme:

Koeficijent prema platnoj listi H-68, H- 377/1

Trajanje ugovora: Šest (6) meseci probnog rada sa mogućnošću produženja.

Potrebna dokumenta:

- Diploma o završenoj odgovarajućoj školi
- Uverenje o profesionalnoj praksi - iskustvo
- Izvod rođenih
- Fotokopija lične karte
- Uverenje o zdravstvenom stanju
- Radna dozvola
- Potvrda da se protiv njega / nje ne vodi istraga


Opština Suva Reka nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve državljane Kosova i pozdravlja prijave svih muškaraca i žena iz svih zajednica na Kosovu.

Nepotpune prijave prema uslovima konkursa kao i one koje stignu posle roka neće se razmatrati.


Zainteresovani obrazac za prijavu za posao mogu dobiti u Opštinskoj direkciji za zdravstvo i socijalnu zaštitu (kod Gradskog parka) u Suvoj Reci.

Konkurs ostaje otvoren 15 dana nakon objavljivanja u dnevnim medijima.

DIREKTOR
Direkcija za zdravstvo i socijalnu zaštitu
Ma.Sc. Besa KUQI



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA –SUHAREKË
OPSTINE SUVA REKA
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA



Direkcija za Zdravstvo i Socijalnu Dobrobit
06. Br. 913
Datum: 02.08.2022

Na osnovu člana 8, tacka 1 i 2 ,Zakona o radu Br-03/L-212 , i ovlašćenjem Predsednika Opštine 01- br- 016-45309 dana : 26.07.2022, Direktor/ka Direkcije objavljuje sledeći:

KONKURS

1.Dva (2) medicinski tehničar u OCPM u Suvoj Reci. Na neodređeno vreme

Naznaka broj: 06- 769
Opis poslova i radnih obaveza: Za poziciju 1

- Da pruža prvu pomoć i vodi brigu o tehničko - fizičkom zbrinjavanju pacijenata.
- Snimi podatke u knjigu protokola i informativni letak.
- Pružiti podršku pacijentima.
- Pregled i učinak u oporavku pacijenata .
- Pružanje terapije i savetovanje pacijenata.
- Poštovanje radnog vremena.
- Poštovanje etičkih profesionalnih kriterija na poslu.
- I druge poslove koje je lider pružio u skladu sa važećim zakonima i propisima.

Puno radno vreme: šest meseci probnog rada sa mogućnošću produčavanja
Mesečna plata: H-68,H- 377/1
Trajanje ugovora: šest(6) meseci probnog rada sa mogućnošću produčavanja
Kandidati koji konkurisu moraju doneti sledeću dokumentaciju :

- Diploma o stručnom obrazovanju;
- Potvrda da je završio/la praksu;
- Licenca za rad;
- Izvod rođenih;
- Fotokopija lične karte
- Uverenje o zdravstvenom stanju
- Potvrda da protiv njega / nje nije pokrenuta istraga.
- Nepotpune prijave po uslovima konkursa i one koje su prispale po isteku roka, neće biti razmatrane.

Opština Suva Reka pruža jednake mogućnosti zapošljavanja svim državljanima Kosova, i rado očekuje aplikacije muških i čenskih osoba svih zajednica koje žive na Kosovu.Svi zainteresovani, obrazac za prijavu mogu dobiti u Opštinskoj Direkciji za Zdravstvo u Suvoj Reci.

Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja u dnevnim sredstvima javnog informisanja.

Direkcija, OCPM
Ma.Sc. Besa KUQI



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

Columbus, Georgia, USA Since 1908